



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

Bazuar në bazuar në Ligjin për Borxhet Publike (Ligji Nr. 03/L - 175), në nenin 38 paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, 01.nr.016-126211 të datës 06.11.2014, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa 01.Nr. 193/2016 të datës 17.10.2016, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më 20.10.2016, miratoi këtë:

V E N D I M

Për autorizimin e kushteve të borxhit afatgjatë nga Qeveria e Austrisë dhe miratimin e Projektit për Rehabilitimin dhe instalimin e kanalizimeve të ujërave të zeza, si dhe rregullimi i shtratit të lumi Mirusha dhe Stanishorka.

1. Me këtë vendim miratohet Projektit për Rehabilitimin dhe instalimin e kanalizimeve të ujërave të zeza, si dhe rregullimi i shtratit të lumi Mirusha dhe Stanishorka
2. Konform projektit për Rehabilitimin dhe instalimin e kanalizimeve të ujërave të zeza, si dhe rregullimi i shtratit të lumi Mirusha dhe Stanishorka aprovohet shuma kryesore e borxhit total 12,200.740.77 €, norma e interesit 0%
3. Komuna e Gjiçanit ka marrë fillimisht pëlqimin nga Ministria e Financave, dhe më pastaj me datën 03.08.2016 Këshilli Kombëtar për Investime ka aprovuar "Plotësimin e listës së Projekteve për Financim përmes 'Klauzolës për Investime'" duke rekomanduar 7,500.00 €, ku me datë 05.08.2016 edhe i ka rekomanduar Qeverisë së Republikës së Kosovës aprovim të vendimit. Ndërsa, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim me datën 19.08.2016 në mbledhjen e 105-të dhe ka aprovuar propozimin e Këshillit Kombëtar për Investime me vendimin Nr. 04/105 me datë 19.08.2016. Të gjitha këto gjitha për të hyrë në procesin e aplikimit pranë Ministrisë së Financave të Austrisë lidhur me programin e kredisë së butë (Soft Loan).
4. Kredia është me grejs-periudha 54 muaj pas përfundimit të projektit apo 4.5 vite pas kryerjes së të gjitha punimeve që është paraparë të zgjasin dy vite. Prandaj duke marrë parasysh grejs periudhën 4.5 vite (6.5 vite viti bazë i kredisë merret viti 2021, Ndërsa, kthimi i kredisë fillon në vitin 2022.
5. Qëllimi i kësaj kredie është trajtimi i ujërave të zeza dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve Mirusha dhe Stanishorka.
6. Ligjin Nr. 04/L-166, Neni 3 dhe marrëveshja e nënshkruar nga Ministria e Financave të Republikës së Kosovës dhe Ministria e Financave të Republikës së Austrisë, e obligon Ministrinë e Financave të Republikës së

Kosovës ta zbatoj Nenin 9, ku thotë “Republika e Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, do të garantoj në mënyrë të parevokueshme dhe pa kushtëzime përmbushjen e të gjitha pagesave që dalin nga kreditë koncesionare Austriake”.

7. Për pjesën e parë të projektit-Rehabilitimin e kanalizimeve të ujërave të zeza, parashihet vlera prej 7,300.000.00 € sipas projektit. Ndërsa, Këshilli Kombëtar për Investime ka aprovuar “Plotësimin e listës së Projekteve për Financim përmes ‘Klauzolës për Investime’” duke rekomanduar 7,500.00€ me titull të projektit: “Rehabilitimi dhe instalimi i kanalizimeve të ujërave të zeza, si dhe rregullimi i shtratit të lumit Mirusha dhe Stanishorka”.
8. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projektit për Rehabilitimin dhe instalimi i kanalizimeve të ujërave të zeza, si dhe rregullimi i shtratit të lumi Mirusha dhe Stanishorka
9. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr. 016-106543
Gjilan, më 20.10.2016

Kryesuesja e Kuvendit,

Valentina Bunjaku-Rexhepi